



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

**Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit**  
**Ministartstvo za Saobraćaj, Poštu i Telekomunikacije**  
**Ministry of Transport and Communications**

Në mbështetje të nenit 93 pika (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 pika (3) të Rregullores së punës së Qeverisë nr. 01/2007, nenit 229 paragrafit 2, 231 paragrafi 1, 237 paragrafi 1 dhe 224 paragrafi 7 të Ligjit nr.02/L-70 për Siguri në Komunikacionin rrugor

Me qëllim të përcaktimit të kushteve dhe procedurës për licencimin e Auto Shkollave në pajtueshmëri me standardet e Bashkimit Evropian.

Nxjerr:

**UDHËZIMIN ADMINISTRATIV Nr. 1/2010**

**PER NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV Nr. 2008/7 PËR LICENCIMIN E AUTOSHKOLLAVE**

**Neni 1**

1. Në paragrafin 2 të Nenit 7, fshihen fjalët “ dhe mjeteve motorike”
2. Neni 7 plotësohet me një paragraf pasues i ri si vijon:  
“4. Auto-shkolla është e obliguar që mjetin ta sjell në Njësinë Rajonale të Patentë Shoferëve, ndërsa verifikimin e ndërrimit të mjetit motorike e bënë vetëm një zyrtar përgjegjës i Ministrisë”.

**Neni 2**

1. Nënparagrafi 1. i paragrafit 1 të Nenit 8, numri 25 fshihet dhe zëvendësohet me numrin 18.
2. Paragrafi 2 i nenit 8, fshihet teksti “në të njëjtin objekt ndërtimor”

Faqe 1 nga 2

### Neni 3

Paragrafi 2 i Nenit 11, plotësohet pas shkronjës B1, plotësohet teksti me shkronjën "B"

### Neni 4

Paragrafi 4 i Nenit 12 fshihet teksti "ose tabela ndriçuese për shënimin e mjetit"

### Neni 5

1. Nënparagrafi 1 i paragrafit 3, të Nenit 14, numri 500, fshihet dhe zëvendësohet me numrin 100
2. Nënparagrafi 2 i paragrafit 3, të Nenit 14, numri 300, fshihet dhe zëvendësohet me numrin 100
3. Nënparagrafi 3 i paragrafit 3, të Nenit 14, numri 100, fshihet dhe zëvendësohet me numrin 50.

### Neni 6

Në shtojcën I, nën fig 2, shtohet teksti "L-pllakëza për kategorinë B është me dimensione 16 x 16 cm<sup>2</sup>"

### Neni 7

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Transportit dhe Postë Telekomunikacionit.

Datë 03.06.2010

Fatmir Limaj,  
Ministër i Transportit dhe Postë- Telekomunikacionit

